



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1077

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) FutureBITS SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje për IT me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1, më 15.12.2025 mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE FutureBITS SH.P.K. me nr. 2025/1077, e datës 02.11.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje për IT me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A., ndërkaq aktiviteti i prokurimit Furnizim me pajisje për IT me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.
3. I shqiptohet vërejtje Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në Autoritetin Kontraktues për moszbatimin e Vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit me numër 2025/0689. Veprim ky që përmban shkelje të detyrimeve ligjore dhe procedurale që rrjedhin nga dipozitat ligjore të LPP.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrja lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik FutureBITS SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 25.06.2025 Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje për IT me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **54,200 €**.

Me 20.10.2025 Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është anuluar aktiviteti.

Me 23.10.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 23.10.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 02.11.2025, OE FutureBITS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1077, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim të aktivitetit.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues FutureBITS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Të nderuar anëtarë të Organit Shqyrtues të Prokurimit,

Ne, si palë e pakënaqur me vendimin refuzues të Autoritetit të datës 23.10.2025, paraqesim këtë ankesë të dytë në lidhje me aktivitetin e njëjtë të prokurimit IL-25-5671-1-2-1 “Furnizim me pajisje për IT”.

Pretendimi 1: Për sqarim dhe thjeshtësim, theksojmë se Autoriteti, me veprimet e tij të fundit, nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë vendimin PSH: 2025/0773, duke devijuar nga qëllimi i rivlerësimit që rrjedh nga vendimi i OSHP-së. Objekt i ankesës sonë në OSHP ka qenë lejimi i dorëzimit të dy broshurave në mungesë, për të cilat kemi vendimin e OSHP-së PSH 2025/0773.

Përshkrim i shkurtër i procesit: Në vendimin e parë, Autoriteti na kishte eliminuar për mungesë të dy broshurave për pozicionet 5 dhe 10, që i përkisnin dy printerëve Ricoh (njëri bardh e zi, tjetri kolor). Këto broshura, për shkaqe teknike, nuk ishin ngarkuar në ofertën tonë fillestare, megjithatë ne kishim dorëzuar broshurat e produkteve të tjera dhe dokumentet përkatëse që lidhen drejtpërdrejt me pozicionet 5 dhe 10. Ekzistenca e këtyre dokumenteve në ofertën tonë fillestare u hapte rrugë ridërgimit të broshurave në mungesë, pa ndryshuar brendin apo ofertën.

Dokumentet në ofertën tonë fillestare: Autorizimi nga distributori zyrtar Ricoh për printerët Garancionet nga distributori zyrtar Ricoh Garancionet tona për printerët Deklarata për përputhshmëri me specifikimet teknike, ku përfshihen të gjitha produktet Aneksi 1 i vulosur dhe nënshkruar, ku përfshihen të gjitha produktet Nëse ne kemi dorëzuar autorizimet dhe garancionet nga distributori zyrtar Ricoh për printerët në emër të projektit, të cilat janë dokumente që garantojnë origjinalitetin dhe përputhshmërinë e produkteve, atëherë është e pakuptueshme se si i njëjti autoritet, që ka pranuar këto dokumente zyrtare, refuzon të pranojë vetëm dy broshurat e prodhuesit të njëjtë. Duke shqyrtuar dosjen e tenderit dhe kërkesat në FDT, Autoriteti kontraktues ka kërkuar dorëzimin e Deklaratës për Specifikacion Teknik (Aneksi 1) dhe broshurat, por nuk ka kërkuar ofertë teknike të detajuar. Ne kemi dorëzuar deklaratën e përputhshmërisë (Aneksi 1). Një qasje e tillë e Autoritetit tregon mungesë koherence profesionale dhe trajtim joobjektiv të çështjes.

Pas vendimit PSH: 2025/0773, me të cilin OSHP urdhëroi rivlerësimin e ofertave, Autoriteti anuloi vendimin e parë dhe më datë 16.10.2025 na dërgoi dokumentin “Kërkesë për dokumente shtesë.pdf” përmes platformës e-Prokurimi. Megjithatë, përmbajtja e këtij dokumenti devijon nga thelbi i procesit dhe nga vendimi i OSHP-së, pasi, edhe pse mban titullin “kërkesë për dokumente shtesë”, brenda tij kërkohet “dëshmi apo evidentim për pikat 5 dhe 10 të dosjes së tenderit në katalogun e ofertuar”, sikur vendimi i OSHP-së të mos ekzistonte fare. Pra, kërkohet sërish të tregojmë se ku ndodhen broshurat në ofertën fillestare, ndonëse dihej se ato nuk ishin pjesë e saj. Kjo tregon qartë tentencë për të rikthyer arsyetimin e parë të eliminimit, në vend se të zbatohet vendimi i OSHP-së që ishte i qartë: lejimi i dorëzimit të dy broshurave në mungesë. Ne, si palë me interes, më 17.10.2025 dorëzuam broshurat për dy printerët Ricoh (pozicionet 5 dhe 10) në përputhje të plotë me kërkesat teknike të dosjes së tenderit (të cilat mund të verifikohen nga ekspertët përmes sistemit e-Prokurimi). Megjithatë, më 20.10.2025 Autoriteti vendosi sërish anulimin e aktivitetit me arsyetimin se “OE nuk i ka përmbushur kërkesat e DT-së”.

Pas pranimit të këtij vendimi, më 23.10.2025 dorëzuam kërkesën për rishqyrtim. Mirëpo, po atë ditë, Autoriteti përsëriti të njëjtin qëndrim refuzues duke deklaruar se “në këtë fazë nuk mund të pranohet katalog shtesë”. Ky veprim përbën moszbatim real të vendimit PSH: 2025/0773, pasi në vend që të kryente rivlerësim të vërtetë, Autoriteti përsëriti të njëjtin refuzim si në vendimin fillestar.

Kjo tregon mungesë respektimi ndaj një vendimi të prerë të OSHP-së, duke shkaktuar vonesa të panevojshme, humbje kohe dhe dëmtim të integritetit të procesit të prokurimit publik. Të humbet gjithë procesi vetëm për dy broshura, ndërkohë që në ofertën fillestare ishin dorëzuar dokumentet kryesore si autorizimet dhe garancionet e distributorit zyrtar Ricoh dhe deklaratat e përputhshmërisë teknike, është e paarsyeshme dhe e pajustificueshme nga ana e Autoritetit. Kërkojmë nga OSHP me mirëkuptim që: Të konstatojë se Autoriteti nuk ka zbatuar drejt vendimin PSH: 2025/0773, duke devijuar nga përmbajtja dhe qëllimi i tij; Të anulojë vendimin e Autoritetit të datës 23.10.2025; Të urdhërojë kthimin e aktivitetit në rivlerësim dhe pranimin e broshurave të dorëzuara nga ne më 17.10.2025.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: Përgjigje nga NH „Ibër Lepenc” Sh.A. Siç është paraqitur edhe në Raportin e Rivlerësimit, të përfunduar më datë 20.10.2025, Komisioni ka konstatuar dhe kjo vërtetohet edhe në platformën e-Prokurimi, si më poshtë: Komisioni i Rivlerësimit konstaton se, pas vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertës me Vendimin e OSHP-së 2025/0773, ka gjetur sa vijon: GOE "FutureBITS" SH.P.K.; “SolvIT” SH.P.K.: Vendimi fillestar i Komisionit të

Vlerësimi, i datës 31.07.2025, është bazuar në Udhëzuesin Administrativ 002/2024, citojmë: "Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara – Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm", pasi në katalogun e ofertuar kanë munguar pikat 5 dhe 10 nga specifikacioni teknik në DT. Ndërsa, pas ankimimit të OE-së në OSHP dhe dorëzimit të katalogut shtesë, OSHP-ja e ka kthyer aktivitetin në rivlerësim, duke u thirrur në nenin 72, respektivisht 69 të LPP-së. Komisioni ka kërkuar “dëshmi apo evidentim për pikat 5 dhe 10 të dosjes së tenderit në katalogun e ofertuar”. Kjo është kërkuar si dëshmi për të siguruar qartësinë dhe përputhshmërinë e dokumentacionit teknik me kërkesat e përcaktuara në DT, në përputhje me vendimin e OSHP-së. Është kërkuar që këto dëshmi të ngarkohen në e-Prokurim brenda dy (2) ditësh, përndryshe tenderi do të refuzohet.

Mirëpo, OE ka dorëzuar katalog shtesë, dhe jo dëshmi apo evidentim në katalogun e ofertuar. Andaj, Komisioni i Vlerësimit konstaton se është kërkuar dëshmi apo evidentim në katalogun fillestar të ofertuar dhe se në këtë fazë nuk mund të pranohet katalog shtesë, pasi katalogut të ofertuar i mungojnë dy modele specifike të printerëve të kërkuar.

Kërkesa e AK-së për “dokumente shtesë” është bërë si në vijim: "Të nderuar, Bazuar në vendimin e panelit të OSHP-së me numër OSHP: 2025/0773 të datës 03.10.2025, tenderi “Furnizim me pajisje për IT” me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1 është kthyer në rivlerësim. Për ta rivlerësuar drejt tenderin, ju lutem të na ofroni si informata shtesë dokumentet si në vijim: Gjatë procesit të rivlerësimit është evidentuar nevoja për: Dëshmi apo evidentim për pikat 5 dhe 10 të dosjes së tenderit në katalogun e ofertuar. Kjo kërkohet si dëshmi për të siguruar qartësinë dhe përputhshmërinë e dokumentacionit teknik me kërkesat e përcaktuara në DT, në përputhje me vendimin e OSHP-së. Këto dëshmi duhet t'i ngarkoni në e-Prokurim në afat prej dy (2) ditësh, në të kundërtën tenderi juaj do të refuzohet. Ju, si palë me interes, nuk keni ofruar dëshmi as evidentim të pikave 5 dhe 10 në katalogun e ofertuar, por keni dërguar katalog të ri/tjetër, i cili në këtë fazë konsiderohet i papranueshëm. Andaj, duke u bazuar në sa u tha më lart, AK NH „Ibër Lepenc” Sh.A. refuzon kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga “FutureBITS”, duke u thirrur në faktin se katalogu i ofertuar nuk i plotëson kërkesat nën pikat 5 dhe 10 të DT-së.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 04.11.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1077, ndërsa me datë 18.11.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1077, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OEFutureBITS SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1077 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1 Pretendimet i parë ankimorë sipas ankesës 1077/25 ka të bëjë me arsyen e AK-së për eliminim të OE ankues, ku sipas AK-së OE edhe përmes rivlerësimit dhe kërkesës për sqarime nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara; “Kërkesa e AK për "dokumente shtesë” është bërë sin ë vijim: “Të nderuar, Bazuar në Vendimin e panelit të OSHP-së me numër OSHP: 2025/0773 të datës 03.10.2025 tenderi " Furnizim me pajisje për IT" me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1 është kthyer në ri-vlerësim. Për ta ri-vlerësuar drejt tenderin, ju lutem që të na ofroni si informata shtesë dokumentat si në vijim: Gjatë procesit të rivlerësimit, është evidentuar nevoja për: Dëshmi apo evidentim për pikat 5 dhe 10 të dosjes së tenderit në katalogun e ofertuar. Kjo kerkohet si dëshmi për të siguruar qartësinë dhe përputhshmërinë së dokumentacionit teknik me kërkesat e përcaktuar në DT, në përputhje me vendimin e OSHP-së.. Këto dëshmi duhet të i ngarkoni në eProkurim në afat prej dy (2) ditësh, ose në të kundërtën tenderi ijuaj do të refuzohet. Ju, si pale e interesit nuk keni ofruar dëshmi e as evidentim të pikave 5 dhe 10 siç kemi kërkuar në katalogun e ofertuar, por keni dërguar katalog të ri/tjetër, e që në këtë fazë konsiderojmë se është e papranueshme.”. Eksperti shqyrtues pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se vendimi i OSHP-së 773/25 e ka kthyer lëndën në rivlerësim në kuptim të nenit 72 të LPP-së.

Mëndmi i ekspertit shqyrtues është se pretendimi i AK-së se OE ka dërguar katalog të ri/tjetër dhe kjo është e papranueshme është i pabazuar në dispozitat të LPP-së, përderisa katalogu i ofruar është për të njëjtat produkte që janë ofruar në ofertën/katalogun fillestar, konsiderojmë se i njëjti duhet të pranohet si i mirëqene. E vetmja përgjegjësi e AK-së në rast të rivlerësimit eventual është të sigurohet se në katalogun i ri kemi të bëjmë me njëjtat produkte si në katalogun e parë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizim me pajisje për IT me numër të prokurimit IL-25-5671-1-2-1.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues

e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në bazë të kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, si dhe obligimit të Autoriteteve Kontraktuese dhe zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e plotë dhe në kohë të vendimeve të OSHP-së, konstatohet se zyrtari përgjegjës i prokurimit ka dështuar të ndërmarrë veprimet e kërkuara sipas vendimit të lartcekur. Ky mosveprim përbën shkelje të detyrimeve ligjore dhe procedurale që rrjedhin nga Ligji për Prokurimin Publik.

Për këtë arsye, shqiptohet Vërejtje zyrtare, duke paralajmëruar se përsëritja e shkeljeve të ngjashme mund të rezultojë në kerkese për marrjen e licences që konsiderohet si mase me e rende disiplinore, në pajtim me rregulloret dhe dispozitat ligjore që rregullojnë përgjegjësinë e personelit në prokurimin publik.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, kështu që urdhëron AK-në që gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërësi dispozitave ligjore të LPP-së.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.**
- **OE - " FutureBITS " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: